



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRSAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE CORRUPTION AGENCY	
Dep. Br. Prot. Nr. Prot.	D-P 03-3191/10
Nr. lfan Nr. pages	Data Datum Date
	21-09-2010

Nr.regj. 16921/10

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, GJYQTARI Ali Latifi, me pjesmarrjen e sekretarës juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Vehbi Ismajli nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 16.paragrafi 1.1. të Ligjit për deklarativin e prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73,74,195, dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet me dt. 30.06.2010, me këtë,

### AKTVENDIM

**I PANDEHURI:** Vehbi Ahmet Ismajli i lindur me 10.01.1965 në Tugjevc KK Kamenicë tani me vendbanim në Prishtinë rr "Bill Clinton" nr 28, ekonomist Ministria e Arsimit, i martuar baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike deri më tani i pa denuar.

### Ë sht e p e r g j e g j e s

Sepse me dt.22.03.2010, si Zyrtar i Lartë Publik është punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe nga Agjensionin për antikorrupsion nuk e ka dërguar formularin për deklarimin e pasurisë edhe pse i jan dërguar formularët e Agjensionit për Antikorrupsion, në formë fizike dhe në elektronike.

Me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 16.paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, andaj për këtë

### Gj O B I T E T

Me gjobë në shumë prej 1000 (Njëmijë) Euro, të cilën gjobë kan për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të mere formën e prerë, në dobi të AFQ I Drejtësis në Prishtinë xhir.rjedhëse 1000-4300-70000-518. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njejta do të zavendsohet me denim burgu në kohëzgjatje prej 30 (Tridhjet) ditësh, duke u, a llogaritur nga 15 euro, në ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse në emër të paushllit gjyqësor I pandehuri është I obliguar të paguajnë shumën prej nga 5 euro në afat dhe xhirologari të njejtë me gjobën.

Pagesa e gjobës dhe paushallit gjyqësor mund bëhet në gjykatën komunale për kundërvajtje në Prishtinë.

Nga një kopje të këtij aktvendimi t,u dërzohet të të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

### A r s y e t i m

**Agjensia Kundër Korrupsionit në Prishtinë**, i parashtror gjykatës kërkesë nr 01-2302/10 të dt. 08.06.2010, për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtari inicoi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të të pandehurit i cili deklaroi: se është e vërtetë se kam marrë materialin me kohë në Ministrinë ku unë punoj dhe këtë nuk e kam dorzuar në Agjensionin kundër Korrupsionit. Kur e kam pa emrin tim në listen e kandidatëve që jan publikuar në mjetet e informimit unë jam para.qit në këtë Institucion.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka marrë në pyetje përfaqsit e Agjensionit Kundër Korrupsionit të cilët ofruan dëshmi të mjaftueshme me 30.06.2010, se i pandehuri për kunder marrjes së materialit për plotësim dhe informim të organeve kompetente për kontrollimin e pasurisë dhe preardhjes të zyrtarëve të lartë, si dhe dhuratave zyrtare që është përcaktuar në nenin 3 të Këtij ligji të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i njejti këtë nuk e ka bërë, andaj kërkojmë që gjykata të vepron sipas kërkesës dhe ligjit që është në fuqi.

Me rastin e shqiptimit të denimit, gjyqtari vlersoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit I,u shqiptua ky lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmën t, shmanget kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmes të kësaj Gjykate pa taksa.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

GJYQTARI  
Mr.Sc. Ali Latifi

